



Primitur / Dostignut Primeni / Protido Received / Delivery		11.10.2022	2	viti god year
Organ / Djësia Organ / Jedinica Org / Unit	Hr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRPMSHICK	6093/2022		112	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.711/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.711/2022 të datës 17.08.2022 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson me adresë

Prishtinë, kundër organit të punësimit/ Agjencia Kosovare e Privatizimit, me bazë juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.711/2022 të datës 17.08.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës Auditore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më datë 17.08.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4771/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.711/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e diferencës së pagës për muajin shkurt - korrik 2022 si dhe njohjen e përvojës së punës në pozitë drejtues lidhur me ushtrimin e pozitës së Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Ndërsa me datë 10.10.2022 e njëjta ka parashtruar kërkesën me numër protokoll 5995/2022 me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.711/2022 të datës 17.08.2022.



Kolegji i Këshillit, pas pranimit të kërkesës me numër protokolli 5995/2022, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.711/2022 të datës 17.08.2022.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 pangari 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.711/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësueses së autorizuar të ankuese
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

